



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/67 Nr. i faq./Br.str/No.pg 80

Data/Datum/Date 30 / 06 / 2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (o) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (i) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 19 të Ligjit Nr. 02/L-57 për Institucionet Kulturore në Republikën e Kosovës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, 40 paragrafi 2 pika 2.8, 57 paragrafi 1 pika 1.15 dhe nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.06.2025, merr këtë:

V E N D I M

Për emërtimin e Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion "Abdullah Bugari"

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/6217/25 i datës 23.06.2025 dhe merret vendimi për emërtimin e Qendrës për Kulturë, Arte dhe Inovacion me emrin "Abdullah Bugari". Abdullah (Zijajdin) Bugari i takon plejadës së djemve e të burrave të Rahovecit të cilët mbajtën barrën e organizimit shoqëror, politik e ushtarak. Abdullah Bugari u mor me ngjarjet më të rëndësishme politike që u zhvilluan anekënd Anadrinit, duke qenë dhe në ballë të demonstratave në mbështetje të UÇK-së, si dhe kundër terrorit shtetëror serb në Prekaz të Drenicës.
Ishte një ndër prijësit e betejës për Rahovecin, në korrik të vitit 1998, në cilësinë e komandantit të kompanisë.
Po ashtu, përveç anës politike, ishte njeri i kulturës dhe artit, i cili shquhej me mjeshtërinë për imitim dhe interpretim, nga e mori dhe nofkën "Humoristi".
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
3. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L/284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.24/2024 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.67/25
Më datë:30.06.2025

